



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 13 datë 26.04.2019

PËR

**“MIRATIMIN E RAPORTIT PËRMBLEDHËS TË VLERËSIMIT “MBI PËRMBUSHJEN E KUSHTEVE TË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE GSM900 DHE GSM1800 TË SIPËRMARRËSIT ALBTELECOM SH.A, TË SHOQËRUAR ME PROPOZIMIN PËR ÇMIMIN REFERENCË MINIMAL PËR RINOVIMIN E AUTORIZIMIT INDIVIDUAL”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Ilir	Zela	Kryetar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtare
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtare
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtare

dhe sekretare Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 26.04.2019, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Mbi miratimin e Raportit Përmbledhës të vlerësimit mbi përmbushjen e kushteve të përdorimit të frekuencave GSM900 dhe GSM1800 të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, të shoqëruar me propozimin për çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual.*

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 71, 73, 114, dhe neni 115, të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në RSH”, i ndryshuar (*Ligji 9918/2008*);
2. Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (*Ligji 44/2015*).

3. Kreu II, i VKM-së Nr.496, datë 22.07.2014 “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurim”, e ndryshuar (**VKM nr.496**);
4. Pika 17.13, Ankesi E, “Kushtet e përgjithshme për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, të Rregullores Nr.47, datë 26.10.2017, “Për zbatimin e Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm” (**Rregullore Nr.47**);
5. Neni 6, i Rregullores Nr.30, datë 05.12.2013, “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave” (**Rregullore nr.30**);
6. Neni 13 dhe 14, i Rregullores së brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të KD të AKEP;
7. Urdhri Nr.110, datë 08/04/2019, i Kryetarit të KD-së së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike “Për ngritjen e grupit të punës për të vlerësuar përmbushjen e të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave GSM 900 dhe GSM 1800 nga sipërmarrësi ALBTELECOM sh.a.”;

### **KËSHILLI DREJTUES I AKEP**

Pasi shqyrtoi materialin shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 2594 prot, datë 05/04/2019, e sipërmarrësit Albtelecom sh.a., me objekt “Mbi Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave në brezat 900/1800 Mhz të Albtelecom sh.a”;
2. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit (*Relacioni*);
3. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
4. Raporti Përmbledhës i përgatitur nga Grupi i Punës;
5. Praktika dokumentare e plotë;
6. Autorizimin Individual për përdorimin e Brezave të Frekuencave 900 MHz dhe 1800 MHz;

si edhe pasi e diskutoi në tërësi çështjen,

### **V Ë R E N:**

I. Në Nenin 73, të Ligjit nr. 9918/2008 përcaktohet se:

- 1) *Me kërkesë të mbajtësit të autorizimit, vlefshmëria e autorizimit mund të shtyhet vetëm në rast se në përfundim të këtij afati janë përmbushur të gjitha kushtet e përdorimit të këtyre frekuencave;*
- 2) *Aplikimet për zgjatjen e vlefshmërisë së autorizimit të frekuencave bëhen jo më pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë përpara përfundimit të vlefshmërisë së tij;*

- 3) *Në rast shtyrje AKEP-i, lëshon një autorizim të ri të përdorimit të frekuencave me një kohëzgjatje jo më të madhe se ajo e autorizimit të mëparshëm.*
- II. Në referim të kësaj dispozite, kushtet ligjore për fillimin e procedurave ligjore të rinovimit të Autorizimit Individual të përdorimit të frekuencave renditen si më poshtë:
- i. Shprehja e interesit nga sipërmarrësi posedues i Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave;
  - ii. Gjendja e vlefshmërisë së Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave në përfundim të afatit të tij;
- III. Në zbatim të pikës 3, të nenit 73, të Ligjit 9918/2008, kuadri ligjor është plotësuar në aspektin procedural me aktin nënligjor VKM nr. 496/2014, mbi bazën e të cilit zbatohet procedura për rinovimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim.
- IV. Në rastin konkret, sipërmarrësi Altelecom sh.a., është paisur me Licencë Nr.253/03/04 datë 01/03/2004 lëshuar aso kohe ndaj Eagle Mobile sh.a, nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (sot AKEP). Ndër të tjera, me anën e kësaj License, sipërmarrësi Eagle Mobile sh.a i jepej e drejta për të ofruar shërbim publik të lëvizshëm tokësor, standardi GSM, në Republikën e Shqipërisë. Në Lidhjen 4 të kësaj License, Eagle Mobile sh.a i janë caktuar:
- i. *Në brezin GSM 900 MHz: kanalet 898,2 deri 906,2 MHz (8 MHz) uplink dhe kanalet 943,2 deri 951,2 MHz (8 MHz) doënlink;*
  - ii. *Për brezin 1800 MHz, në Lidhjen 4 pika 2, është vendosur ky shënim: “Të Licensuarit, ashtu si dhe operatorëve të tjerë AMC dhe Vodafone Albania, i njihet e drejta të përdorë për zgjerimin e shërbimit të tij edhe brez frekuencash në bandën DCS 1800 në momentin që do të kërkohet nga ai”.*
- V. Me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 532 datë 26.12.2008 “Për Autorizimin Individual të Operatorit të Telefonisë së Lëvizshme GSM në Republikën e Shqipërisë - Eagle Mobile sh.a”, në zbatim të përcaktimeve të ligjit të ri nr. 9918 date 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republikën e Shqiperise”, KD i AKEP ndër të tjera ka vendosur:
- i. Shfuqizimin e Licencës Nr.253/03/04 datë 01/03/2004 të operatorit Eagle Mobile sh.a.;
  - ii. Pajisjen e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave të brezit GSM:
    - Tabela 1, Brezi GSM 900 MHz: kanalet 898,2 deri 906,2 MHz (8 MHz) uplink dhe kanalet 943,2 deri 951,2 MHz (8 MHz) doënlink.
    - Tabela 2, Brezi GSM 1800 MHz: e paplotësuar.
- VI. Me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 937 datë 17.08.2009 “Për amendimin e VKD Nr. 532 datë 26.12.2008 “Për Autorizimin Individual të Operatorit të Telefonisë së Lëvizshme GSM në Republikën e Shqipërisë - Eagle Mobile sh.a”, Këshilli Drejtues i AKEP, bazuar në kërkesën e Eagle Mobile sh.a, ka vendosur amendimin e VKD Nr.

532 datë 26.12.2008, duke i caktuar sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a frekuencat e brezit GSM 1800:

- Tabela 2, Kanalet GSM 1800 MHz: 1710,2 deri 1719.0 MHz (9 MHz) uplink dhe kanalet 1805,2 deri 1814.0 MHz (9 MHz) downlink.

- VII. Me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2270 date 13.02.2013 “Per kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe në Autorizimet e Përgjithshme dhe Autorizimet Individuale para bashkimit me përthithje të sipërmarresit Eagle Mobile sh.a, tek subjekti tregtar përthithës Albtelecom sh.a”, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar kalimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezit GSM 900 dhe GSM 1800 sipas aneksit të Autorizimit Individual, miratuar me VKDNr. 532 date 26.12.2008, nga sipërmarrësi "Eagle Mobile" sh.a tek sipërmarrësi "Albtelecom"sh.a.
- VIII. Me shkresën me nr. 882 prot, datë 31/01/2019, sipërmarrësi “Albtelecom sh.a” ka paraqitur pretendimin se ka gëzuar/përdorur efektivisht për vetëm 11 vjet Licencën për shërbimet GSM për brezin 900 MHz, dhe vetëm 10 vjet Licencën për shërbimet GSM të brezit 1800 MHz, pasi pavarësisht datës së lëshimit të Licensës, ky Akt administrativ nuk ka filluar fuqinë juridike në datën e lëshimit, por vetëm pas 4 viteve kur u plotësuan kushtet të cilat penguan fillimin e efekteve juridike, dhe se në rastin konkret nuk mund të bëjmë referim tek neni 73 i ligjit 9918/2008 pasi ky sipërmarrës nuk e ka fituar të drejtën e përdorimit të këtyre frekuencave nëpërmjet procedurave të konkurrimit sipas parashikimeve të neneve 68 dhe 69 të ligjit 9918/2008, por me ligj të veçantë. “Albtelecom” sh.a kërkoi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë me 4 vjet për frekuencat e brezit 900 MHz dhe me 5 vjet afatin e vlefshmërisë për frekuencat e brezit 1800 MHz.
- IX. Me Shkresën e AKEP Nr. 235/1 datë 25.02.2019 drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me procesin e ndryshimit të Autorizimit Individual të Albtelecom sh.a për përdorimin e brezave 900 dhe 1800 MHz, AKEP ka kërkuar pëlqimin paraprak për ndryshimin e Autorizimit Individual të Albtelecom sh.a dhe zgjatjen e vlefshmërisë së tij, duke paraqitur situatën ligjore dhe rrethanat e kohës për pajisjen me Licensë te operatorit, si dhe propozimin e AKEP për adresimin e kësaj situate. Në përgjigjen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 235/3 prot. (i AKEP) datë 28.03.2019, përgjigje shkresës së AKEP datë 25.02.2019, është shprehur mendimi se procesi i miratimit të rinovimit për Autorizimet Individuale bazohet tërësisht në rregullat dhe procedurën e parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 496 date 22.07.2014. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë gjithashtu ka theksuar se mbi bazën e këtyre rregullave dhe procedurave të miratuara në aktin nënligjor VKM nr. 496, janë rinovuar deri më tani dhe frekuencat e brezit 900 dhe 1800 MHz për sipërmarrësit e tjerë që operojnë në tregun e telefonisë së lëvizshme (Vodafone Albania sh.a dhe Telekom Albania sh.a), duke nënvizuar faktin që secili prej tyre kanë paguar respektivisht [REDAKTUAR] për buxhetin e shtetit për një afat 15 vjet.
- X. Me Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 9 datë 28.03.2019 “Mbi kërkesën e sipërmarrësit Albtelecom sh.a lidhur me Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz dhe 1800 MHz”, Këshilli Drejtues i AKEP ka vendosur:
- Të përgatitet një përgjigje zyrtare për sipërmarrësin Albtelecom sh.a, ku të informohet lidhur me trajtimin ligjor të kësaj çështje, si dhe mospranimin e

kërkesës së tij me objekt “Mbi ndryshimin e Autorizimit Individual per perdorimin e frekuencave te brezave 900 MHz dhe 1800 MHz”.

- Ti kërkohet zyrtarisht Altelecom sh.a për të shprehur interesin nëpërmjet kryerjes së aplikimit për rinovimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz dhe 1800 MHz, në përputhje me VKM Nr. 496.
- Sipërmarrësit Altelecom sh.a, ti lihet afati kohor ligjor 10 ditor, për të shprehur interesin dhe për të proceduar me kryerjen e aplikimit për rinovimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz dhe 1800 MHz, sipas legjislacionit në fuqi.

- XI. Me shkresën e AKEP nr. 235/4 prot. (i AKEP) datë 29.03.2019 drejtuar Altelecom “Mbi Autorizimin Individual per perdorimin e frekuencave te brezave 900 MHz dhe 1800 MHz”, AKEP i ka bërë me dije Altelecom sh.a se afati i vlefshmërisë së Autorizimit Individual për brezat 900 MHz dhe 1800 MHz ka përfunduar dhe në vijim të procedurës së parashikuar në nenin 73, të Ligjit 9918/2008 dhe VKM nr. 496, Altelecom sh.a. të vleresojë shprehjen e interesit nëpërmjet kryerjes së aplikimit rinovimin e autorizimit individual, brenda një afati 10 ditor.
- XII. Me shkresën e Altelecom sh.a nr. 235/6 prot. (i AKEP) datë 05.04.2019 “Mbi Autorizimin Individual per perdorimin e frekuencave te brezave 900 MHz dhe 1800 MHz”, në përgjigje të shkresës së AKEP nr. 235/4 prot. (i AKEP) datë 29.03.2019, Altelecom sh.a nder te tjera, ka shprehur interesin për rinovimin e Autorizimit Individual për 15 vjet të tjera, në përputhje me bazën ligjore të cituar nga AKEP, dhe informon se ka përbushur të gjitha kushtet dhe detyrimet lidhur me përdorimin e frekuencave, duke deklaruar se zotëron të gjitha kapacitetet për të vijuar përbushjen plotësisht të detyrimeve të Autorizimit Individual. Në përfundim, sipërmarrësi në fjalë ka shprehur qëndrimin e tij për llogaritjen dhe vlerën e çmimit minimal reference për rinovimin e Autorizimit Individual.
- XIII. Në këtë kontekst, gjykohet se sipërmarrësi Altelecom sh.a., referuar bazës ligjore dhe fakteve të më sipër cituara, plotëson kushtet ligjore për paraqitjen në AKEP të kërkesës për zgjatjen e vlefshmërisë dhe rinovimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave në brezat GSM 900 MHz dhe GSM 1800 MHz.
- XIV. Titullari i AKEP, mbështetur në shkronjën a), të nenit 8, nenin 71 dhe 73, të Ligjit 9918/2008, për kryerjen e detyrave të parashikuara në VKM-në 496/2014, nxori Urdhrin nr. 110, datë 08/04/2019, për ngritjen e grupit të punës për të vlerësuar përbushjen nga sipërmarrësi Altelecom sh.a. të të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave GSM 900 dhe GSM 1800 të përcaktuara në Autorizimi Individual dhe Autorizimin e Përgjithshëm.
- XV. Në zbatim të Urdhërit nr.110, datë 08/04/2019, AKEP nëpërmjet grupit të punës të ngritur për këtë qëllim, filloi veprimet paraprake për të vlerësuar përbushjen nga ky sipërmarrës të kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit GSM të përcaktuara në Autorizimin Individual për sipërmarrësin Altelecom sha. Grupi i punës, në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 9, të Kreut II, të VKM nr. 496/2014, mbi bazën e informacionit të administruar për këtë qëllim, ka kryer vlerësimin e përbushjes të të gjitha kushteve të përdorimit të këtyre frekuencave sipas Autorizimit Individual dhe atij të Përgjithshëm, si dhe të dhënave të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 te Kreut II te VKM

nr. 496/2014, duke nxjerrë në përfundim të procesit, Raportin Përmbledhës të Vlerësimit mbi përmbushjen nga sipërmarrësi Albtelecom sh.a., të të gjitha kushteve sipas Autorizimit Individual dhe atij të Përgjithshëm, për përdorimin e frekuencave GSM 900 dhe GSM 1800.

XVI. Në përputhje me pikën 8, të Kreut II, të VKM nr.496/2014, RPV shoqërohet me propozimin mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual.

XVII. Grupi i punës në zbatim të këtij detyrimi, bazuar në:

- a) Përcaktimet e parashikuara në pikat 9, 10 dhe 11 të Kreut II të VKM nr. 496/2014;
- b) Administrimin e informacionit për këtë qëllim;
- c) Parimin e objektivitetit, transparencës, jo diskriminimit dhe proporcionalitetit;

zhvilloi procesin e vlerësimit dhe llogaritjes së çmimit referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual dhe hartoi dokumentin me propozimin përkatës, i cili shoqëron RPV. Propozimi për çmimin referencë minimal shoqërohet me argumentimin e AKEP për caktimin e tij. RPV i shoqëruar me propozimin mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual, në mbështetje të pikës 6, të Kreut II të VKM nr. 496/2014, i paraqiten Këshillit Drejtues të AKEP për miratim.

XVIII. Në përfundim të procedurës së zbatuar sipas VKM nr. 496/2014, për vlerësimin e përmbushjes nga sipërmarrësi Albtelecom Sh.a., të të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave sipas Autorizimit Individual (AI) dhe atij të Përgjithshëm (AP), të materializuar në RPV, arrihet në konkluzionin se:

*Sipërmarrësi Albtelecom sh.a., i regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve të AKEP me Ref. Nr. AKEP-2012-AP-U108-1, datë 12.03.2012, plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe kushtet për përdorimin e AI, në përputhje me ligjin 9918/2008 dhe të Kreut II, të VKM 496/2014.*

XIX. Në vijim, në vlerësim të praktikës dokumentare rezulton se sipërmarrësi ka përmbushur plotësisht kushtet si më poshtë:

- a) detyrimin për ofrimin e shërbimeve publike të telefonisë së lëvizshme në të gjithë territorin e vendit sipas kushteve të vendosura në AI dhe AP;
- b) detyrimin për mbulimin me shërbime publike të telefonisë së lëvizshme në përqindje të popullsisë dhe në shkallë gjeografike;
- c) kushtet mbi rrjetin e aksesit dhe rrjetin kryesor;
- d) kushtet mbi mënyrën e shfrytëzimit të frekuencave GSM 900 dhe GSM 1800 në territorin e vendit;
- e) kryerjen e pagesave;
- f) marrjen e masave për të siguruar përdorimin eficient të frekuencave;
- g) kushtet teknike të funksionimit, të nevojshme për shmangien e interferencave të dëmshme dhe kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike;
- h) detyrime që rrjedhin nga aktet dhe marrëveshjet ndërkombetare, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- i) detyrimet e përcaktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave për këtë brez frekuencash;



- j) Kushtet për shfrytëzimin e burimeve të Planit Kombëtar të Numeracionit në funksion të shfrytëzimit të spektrit të frekuencave GSM të autorizuar për të ofruar shërbime të telefonisë së lëvizshme;
- k) Përbushjen e detyrimeve për cilësinë e shërbimeve të ofruara, etj.

XX. Për llogaritjen e çmimit referencë minimal grupi i punës ka marrë në konsideratë këta faktorë:

- a) nxitjen e një konkurrence sa më efiçente në tregun e komunikimeve elektronike dhe përdorimin sa më të frytshëm të frekuencave;
- b) përdorimi efikas dhe pa interferenca i spektrit radio në brezin GSM 900/1800 MHz;
- c) vlerësimin ekonomik në përputhje me praktikën më të mira Evropiane;
- d) interesin e konsumatorit për çmime më të lira dhe më të përballueshme të shërbimeve në nivel pakice në Shqipëri;
- e) rritjen e cilësisë së shërbimeve, nëpërmjet rinovimit dhe modernizimit të rrjeteve;
- f) vlerat e marra në tenderat për dhënie në përdorim të brezave të frekuencave të brezit GSM 900/1800 nga ofertuesit.
- g) studime të kryera nga kompani ndërkombëtare të fushës së vlerësimit të spektrit, etj.
- h) argumentat e sipërmarrësit Albtelecom sh.a, dhe propozimin që tarifa për zgjatjen e afatit të Autorizimit Individual për një periudhë prej 15 vjetësh të jetë [REDACTED].

XXI. Si përfundim, propozimi për çmimin minimal referencë për rinovimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave 900/1800 MHz (2x8 në 900 MHz dhe 2x9 MHz në 1800 MHz) të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, në vlerën [REDACTED], bazohet në kritere dhe metodologji që merr në konsideratë zhvillimin e konkurrencës, interesin publik dhe mbrojtjen e konsumatorit, në rrethanat e tregut dhe përdorimin efektiv të frekuencave si dhe mendimin paraprak të sipërmarrësit si palë e interesuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 73, pikën 1, të nenit 114, 115, të Ligjit nr. 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Kreut II të VKM-së 496/2014, Këshilli Drejtues i AKEP:

### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë dokumentin: “Raport Përmbledhës për vlerësimin e përbushjes së kushteve të përdorimit të Autorizimit Individual të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, shoqëruar me propozimin për çmimin minimal referencë për rinovimin e Autorizimit Individual”.
2. T’i paraqesë Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, aktin e miratuar sipas pikës 1 të mësipërme, duke i propozuar vijimin e procedurës sipas Kreut III të VKM nr. 496/2014.

3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar**  
**Ilir ZELA**

**Anëtar**  
**Edlira DVORANI**

**Anëtar**  
**Xhoana LILAJ**

**Anëtar**  
**Ketrin TOPÇIU**